



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Ministarstvo Industrije, Preduzetnistva i
Tergovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MTI) nr. 01/2018 për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, Vendimin nr. 5235 datë 15.07.2021 dhe Vendimin nr. 393/01 datë 09.06.2023 me qëllim të zvogëlimit të deficitit tregtar dhe përmirësimit të kapaciteteve prodhuese të artizaneve, rritjen e investimeve, rritjes së eksportit, konkurrueshmërisë dhe hapjen e vendeve të reja të punës, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpallë:

Thirrje publike për subvencionim me mjete financiare për Artizane

MINT/KIESA do të mbështes në subvencionim me mjete financiare artizanet (ndërmarrjet mikro dhe të vogla). Të interesuarit për aplikim në këtë thirrje duhet të jenë të regjistruar në Republikën e Kosovës.

Buxheti i planifikuar për subvencionim për këtë thirrje është 400,000.00 €. Në secilin rast Autoriteti Kontraktues (MINT) rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion.

Granti do të ndahet në dy Lot-e, si vijon:

Loti 1 – Ndërmarrjet mikro (të punësuar deri në 9 punëtorë)

Buxheti total për kategorinë e ndërmarrjeve mikro është 250,000.00€

Loti 2 – Ndërmarrjet e vogla (të punësuar 10 deri në 49 punëtorë)

Buxheti total për kategorinë e ndërmarrjeve të vogla është 150,000.00€

Për të gjitha procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm, MINT/KIESA ka përgatitur udhëzues për aplikant të cilët do t'i gjeni në linkun: <https://mint.rks-gov.net/> dhe <https://kiesa.rks-gov.net/> ndërsa për të aplikuar online kliko këtu: ekosova.rks-gov.net

Thirrja për aplikim është e hapur prej datës 12.07.2024 deri 01.08.2024.